



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 424/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Iniciativës Qytetare (IQD) dega në Drenas, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Drenas, për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Iniciativës Qytetare (IQD), dega në Drenas.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.11.2013, nga Iniciativa Qytetare dega në Drenas, me të cilën theksohet se Kryetari i Komunës së Drenasit ka inkurajuar shërbyesit civil të administratës Komunale dhe drejtuesit e Komunës së Drenasit të cilët mbajnë poste publike, që të përfshihen në aktivitet të fushatës Zgjedhore të organizuar nga dega e subjektit politik PDK në Drenas, me pezullimin e ushtrimit të detyrës dhe përgjegjësive të përcaktuara me ligj Nr.04/-05 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dispozitat nga nenin 35 pika 2 të Ligjit Nr.03/L-73 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Si provë ka bashkangjitur tetë fotografi për mungesën e stafit drejtues dhe shërbyesve civil në orar të punës me datë 01.11.2013.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 02.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës. Sipas afatit të caktuar nga PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë, në të cilën theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, sipas të dhënave që kemi nga tereni këto pretendime nuk qëndrojnë, PDK nuk ka inkurajuar në asnjë moment asnjë shërbyes civil që ti bashkëngjitet tubimeve elektorale, mandej nuk mundë të gjendet asnjë fakt për pretendimet që ka bërë kjo iniciativë me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore se kryetari i komunës së Drenasit i ka inkurajuar shërbyesit që të dalin në fushatë zgjedhore nuk qëndrojnë ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi që i vërtetojnë pretendimet e parashtruar në ankesë, andaj pretendimet e tilla u vlerësuan si të pabazuar dhe ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 424/2013 më datën 04.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Këshillë Juridike: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*